

VENDIM
Nr. 21, datë 17.1.2024

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 150, DATË 13.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E KRITEREVE DHE TË NORMAVE TË TRAJTIMIT ME UNIFORMË TË USHTARAKËVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 150, datë 13.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kriterëve dhe të normave të trajtimit me uniformë të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Ushtarakët aktivë, që shërbejnë në Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura, trajtohen me uniformë ushtarake, sipas shtojcës nr. 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

b) Në pikën 3, togfjalëshi “... në pikat 1 dhe 2 ...” zëvendësohet me “... në pikat 1, 2 dhe 2/1 ...”;

c) Shtojca nr. 12 zëvendësohet me shtojcën me të njëjtin numër dhe emërtesë, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

ç) Pas shtojcës nr. 12 shtohet shtojca nr. 13, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA NR. 12

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT QË SHKOJNË ME MISION JASHTË VENDIT

Nr .	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Koment
		Sasia	Afati në muaj	
I.	UNIFORMA E STËRVITJES			
1.	Kostum stërvitje (xhaketë, pantallona, kapelë)	1	6	
2.	Bluzë me mëngë të gjata	2	6	
3.	Bluzë me mëngë të shkurtra	2	6	
4.	Pantallona të brendshme (benevrekë)	1	6	
5.	Rrip pantallonash	1	6	
6.	Rrip mesi	1	6	
7.	Çorape të gjata	4	6	
8.	Këpucë stërvitjeje lëkure	1	6	
9.	Këpucë stërvitjeje lëkure/najlon (verore)			Opsion në vend të këpucëve të stërvitjes të lëkurës
10.	Kapelë e madhe	1	6	

11.	Doreza luftimi	1	6	
-----	----------------	---	---	--

Shënime:

1. Gradat dhe dekoracionet që mbahen në uniformë janë pjesë e uniformës.
2. Lloji i uniformës së stërvitjes, me të cilën do të kompletohen efektivët që shkojnë në misione jashtë vendi, me kohëzgjatje mbi 3 (tre) muaj, do të përcaktohet në urdhrat e ministrit të Mbrojtjes, rast pas rasti.

SHTOJCA NR. 13

NORMAT E ARTIKUJVE TË UNIFORMAVE USHTARAKE PËR USHTARAKËT AKTIVË TË ORKESTRËS SIMFONIKE TË FORCAVE TË ARMATOSURA

Nr .	Artikujt e uniformave	Normat dhe afatet e përdorimit		Komente
		Sasia	Afati në vite	
I.	UNIFORMA CEREMONIALE (TOKËSORE/AJRORE) PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË			
1.	Khaketë	1	5	
2.	Pantallona	1	5	
3.	Fund			Opsion në vend të pantallonave për femrat
4.	Kapelë	1	5	
5.	Këmishë me mëngë të gjata	1	2	
6.	Këmishë me mëngë të shkurtra			Opsion në vend të këmishës me mëngë të gjata
II.	UNIFORMA CEREMONIALE DETARE E BARDHË PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË/DETARË			
1.	Khaketë	1	5	
2.	Pantallona	1	5	
3.	Fund			Opsion në vend të pantallonave për femrat
4.	Këpucë të bardha për femra	1	5	
5.	Këpucë të bardha për meshkuj	1	5	
6.	Këmishë e bardhë me mëngë të shkurtra	1	2	
7.	Rrip pantallonash i bardhë	1	5	
III .	UNIFORMA E PUNËS TOKËSORE (VETËM PËR OFICERËT DHE NËNOFICERËT)			
1.	Khaketë	1	2	
2.	Pantallona	2	2	
3.	Fund			Opsion në vend të pantallonave për femrat
4.	Kapelë pune	1	4	
5.	Beretë	1	3	Ngjyrë e zezë
6.	Kapelë zarf			Opsion në vend të beretës
7.	Këmishë me mëngë të gjata	2	1	
8.	Këmishë me mëngë të shkurtra	2	1	
9.	Bluzë pambuku me mëngë të shkurtra	2	1	
IV .	ARTIKUJ TË TJERË PËR UNIFORMËN CEREMONIALE DHE TË PUNËS			
1.	Kollare	1	3	
2.	Rrip pantallonash	1	3	
3.	Xhuboks (xhaketon)	1	3	
4.	Xhup dimëror	1	5	
5.	Pardesy			Opsion në vend të xhupit dimëror
6.	Pardesy kundër shiut	1	6	
7.	Pulovër	1	4	
8.	Pantallona verore	1	1	
9.	Fund veror			Opsion në vend të pantallonave verore për femrat
10.	Gete			Opsion në vend të çorapeve për femrat
11.	Çorape	4	1	
12.	Këpucë gjysma pune për meshkuj	1	1	
13.	Këpucë gjysma ceremoniale për meshkui	1	5	Vetëm për ata që trajtohen me uniformë ceremoniale tokësore dhe

				ajrore
14.	Këpucë dimërore (meshkuj/femra)	1	3	
15.	Këpucë verore për femra	1	1	
16.	Çizme			Opsion në vend të këpucëve dimërore për femrat
17.	Kordon dekorativ i uniformës ceremoniale	1	10	
18.	Shenja e emrit	1	5	
19.	Suport për medaljet dhe dekoratat	1	10	
20.	Stema dhe distinktivë	1	5	Jepen kur emërohet për herë të parë
21.	Doreza lëkure	1	6	
22.	Doreza ceremoniale të bardha	1	3	
V.	UNIFORMA E STËRVITJES PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË			
	Uniforma e stërvitjes kamuflazh – “Woodland”			
1.	Kostum stërvitje (xhakëtë, pantallona, kapelë)	1	3	
2.	Xhup dimëror	1	5	
3.	Bluzë “polo” me mëngë të shkurtra	1	2	
4.	Bluzë me mëngë të gjata	1	1	
5.	Bluzë me mëngë të shkurtra	1	1	
6.	Pantallona të brendshme (benevrekë)			
7.	Rrip pantallonash	1	5	
8.	Rrip mesi	1	7	
9.	Çorape të gjata	2	1	
10.	Këpucë stërvitjeje lëkure	1	5	
11.	Këpucë stërvitjeje lëkure/najlon (verore)			Opsion në vend të këpucëve të stërvitjes të lëkurës
VI	UNIFORMA SPORTIVE PËR OFICERË, NËNOFICERË, USHTARË			
1.	Kostum sportiv (pantallona + bluzë me mëngë të gjata)	1	3	
2.	Kostum sportiv (pantallona të shkurtra + bluzë me mëngë të shkurtra)	1	3	
3.	Këpucë sportive (atlete)	1	3	
VI I	UNIFORMA E DARKAVE ZYRTARE (VETËM PËR OFICERËT DHE NËNOFICERËT)			
1.	Kapelë	1	12	
2.	Xhakëtë	1	12	
3.	Pantallona	1	12	Vetëm për meshkujt
4.	Fund	1	12	
5.	Këmishë me mëngë të gjata	1	12	
6.	Papion	1	12	
7.	Kostum civil (xhakëtë, pantallona, fund)	1	7	Fundi, opsion për femrat në vend të pantallonave.

Shënime:

1. Gradat dhe dekoracionet që mbahen në uniformë janë pjesë e uniformës.
2. Trajtimi me uniformë ceremoniale i Orkestrës Simfonike të FA-së të bëhet e ndarë me tri llojet e uniformave: tokësore, ajrore, detare e bardhë, në proporcion të barabartë, ku ushtaraku që do të trajtohet me njërin nga llojet e uniformës ceremoniale do të vijojë të trajtohet gjithmonë vetëm me atë lloj uniforme dhe nuk do të trajtohet me asnjë lloj tjetër uniforme ceremoniale.
3. Ushtarakët aktivë që emërohen për herë të parë në Orkestrën Simfonike të FA-së, në rast largimi nga Forcat e Armatosura, për arsye të ndërprerjes së njëanshme të kontratës, detyrohen të zhdurojnë vlerën e mbetur të uniformës me të cilën janë furnizuar.